

UDHËZIM
Nr. 15, datë 12.6.2023

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008, “PËR PROCEDURAT
TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të të nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas pikës 114.4 të udhëzimit, shtohet pika 114.5 me këtë përmbajtje:

“114.5 Gjohet për deklaratë të pasaktë dhe pagesë të vonuar të detyrimeve për shkak të ndryshimit të listëpagesave dhe gjohet për deklaratë të vonuar të formularëve të të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna, nuk aplikohen për organet e qeverisjes qendrore apo vendore, institucionet kushtetuese dhe institucionet e tjera që financohen nga buxheti i shtetit, në rastet e:

- a) zbatimit të një akti ligjor apo nënligjor me efekte prapavepruese;
- b) zbatimit të një vendimi gjykate të formës së prerë;
- c) zbatimit të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës së Lartë;
- d) vonesave në nxjerrjen apo dërgimin e vendimeve të emërimit të punonjësve nga organet që kanë këtë të drejtë.

Në këto raste, gjohet ndaj organeve të përcaktuara në paragrafin e parë nuk zbatohen pasi deklaratimet apo ndryshimet e listëpagesave me vonesë nuk kanë ardhur për shkak të veprimit apo mosveprimit të këtyre institucioneve.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj